

СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

21.11.2016.

V E N D I M

I Komisionit për ankesa pranë Këshillit për etikë në mediat e Maqedonisë (KEMM), pas ankesës së Xhelal Nezirit për tekstin me titull “VESEL QAZIMI – XHELAL NEZIRIT: KJO QË PO BËN ËSHTË POSHTËRSI MBI POSHTËRSITË”, i publikuar më 07.10.2016, në portalin e Internetit Gostivari24 (www.gostivari24.com)

ANKESA ËSHTË E JUSTIFIKUAR

Është shkelur Neni 1 dhe 4 i Kodeksit të gazetarëve të Maqedonisë.

Neni 1.

“Gazetari ka të drejtë për qasje të lirë gjer të gjitha burimet e informimit, të cilat janë në interes publik. Gazetari duhet të botojë informata të vërteta e të konfirmuara dhe nuk do të fshehë të dhëna esenciale ose të falsifikojë dokumente. Në qoftë se informata nuk mund të konfirmohet, ose nëse bëhet fjalë për supozim, respektivisht spekulim, kjo gjë duhet cekur dhe botuar. Saktësia e informatës duhet vërtetuar aq sa është e mundur.”

Член 4.

“Gazetari do të cekë burimin e informatave, mirëpo, nëse burimi kërkon që të mbetet anonim, gazetari do ta mbrojë atë.”

ARSYETIMI



СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

Më 20.06.2016, Xhelal Neziri parashtroi ankesë deri te Zyra ekzekutive e Këshillit për etikë në mediat e Maqedonisë për tekstin me titull “VESEL QAZIMI – XHELAL NEZIRIT: KJO QË PO BËN ËSHTË POSHTËRSI MBI POSHTËRSITË”, i publikuar më 07.10.2016, në portalin e Internetit Gostivari24 (www.gostivari24.com).

Në ankesë thuhet se teksti transmeton deklaratën e Vesel Qazimit, i cili atribuon deklaratën e cila nuk është e Nezirit, por koment i portalit zhurnal.mk. Në arsyetimin e ankesës thuhet se janë transmetuar shpifje dhe akuza në bazë të deklaratës së përmendur. Më tej thuhet se portali ka marrë statusin e Nezirit, i cili është postuar në Facebook dhe është vënë në kontekst të mbështetjes së shpifjes.

Zyra ekzekutive e KEMM-it, në pajtim me nenin 12 të Rregullores së Komisionit për ankesa, pas pranimit dhe shqyrtimit të ankesës, kontaktoi me portalin e internetit Gostivari24 dhe kërkoi nga redaksia që të prononcohet lidhur me pretendimet në ankesë. Portali në fjalë nuk dërgoi përgjigje lidhur me pretendimet e ankuesit.

Komisioni për ankesa konstatoi se ankesa lidhur me përmbajtjen është e JUSTIFIKUAR.

Në seancën e datës 08.11.2016 година, Komisioni për ankesa shqyrtoi pretendimet e ankuesit, Xhelal Neziri, dhe inspektoi tekstin në fjalë.

Anëtarët e Komisionit konstatuan se në tekstin e përgjithshëm janë marrë dy statuse të Facebook të Vesel Qazimit dhe Xhelal Nezirit. Nga vetë inspektimi i tekstit mund të konstatohet se ai nuk paraqet kurrfarë produkti gazetaresk dhe, në fakt, nuk mund të përcaktohet zhanri.

Me strukturën e tekstit të vendosur në këtë mënyrë, fitohet përshtypja se janë dhënë pohime të cilat janë subjekt i sulmeve dhe kritikave, për të cilat nuk është konsultuar pala e prekur dhe me të



СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

cilat hutohet lexuesi, sepse me këtë strukturë të tekstit i cili nuk i takon asnjë zhanri mund të nxirren vetëm përfundime individuale jo objektive politike pasi që tema është e papërpunuar. Përzgjedhja e fakteve na siguron informacion objektiv.

Autori nuk i kontrollon të dhënat dhe motivet për statuset e shkruara në FB, me ç'rast bëhet pasqyrim i shtrembëruar te lexuesi.

Komisioni për ankesa konstatoi se në tekstin e kontestueshëm me titull “Vesel Qazimi – Xhelal Nezirit: Kjo që po bën është poshtërsi mbi poshtërsitë”, i publikuar më 07.10.2016, në portalin e Internetit Gostivari 24, është shkelur Neni 1 i Kodit të gazetrëve të Maqedonisë, sipas të cilit kontrollimi dhe saktësia e të dhënave janë imperativ moral i gazetarisë, dhe për këtë arsye, gazetari është i obliguar ta kontrollojë informacionin nga sa më shumë burime, së paku dy burime të pavarura. Përzgjedhja e fakteve duhet të sigurojë informacion objektiv dhe të marrë parasysh të gjitha aspektet e rëndësishme të temës në fjalë. Gjithmonë duhet bërë përpjekje për të ruajtur kontekstin origjinal të të gjitha civateve apo fragmenteve. Raportimi gazetaresk nuk guxon ta ndryshojë kuptimin e fjalisë, deklaratës a citatit. Gazetari duhet të sigurojë “palën e dytë”, respektivisht, t’u japë mundësi të gjitha palëve të prekura nga produkti gazetaresk që ta tregojnë qëndrimin e tyre. Kjo vlen në veçanti në rastet kur gazetari paraqet dyshime a akuza, ose kur dikush është subjekt i sulmit dhe kritikës.

Më tutje, Komisioni konstatoi se është shkelur Neni 4, sipas të cilit burimi i informacionit duhet të identifikohet, përveç atëherë kur kjo mund të ndikojë në sigurinë e tij apo sigurinë e palës së tretë. Gazetari gjithmonë duhet të jetë kritik ndaj burimit dhe t’i kontrollojë informacionet e fituara. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar situatave kur përdoren burime anonime ose kur gazetarit i ofrohen informacione ekskluzive. Në këtë rast, duhet në mënyrë rigorozë të kontrollohen motivet e dorëzuesit të informacionit. Heshtja dhe mospublikimi i të dhënave të cilat mund të ndikojnë në



СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

qëndrimin e publikut është e njëjtë me shtrembërimin e qëllimshëm të tyre, apo me manipulimin e vetëdijshëm me publikun.

Në përputhshmëri me këtë, Komisioni vendosi si në dispozitivin.

Në punën e Komisionit për ankesa morën pjesë anëtarët Mirçe Adamçevski, Filip Gjurçinovski, Meri Jordanovska, Sefer Tahiri, Goce Gerasimovski, Teofill Bllazhevski dhe Bekim Ajdini.

Në përputhshmëri me Nenin 18 të Rregullores për punë të Komisionit për ankesa, obligohet portali i Internetit Gostivari24 (www.gostivari24.mk) që ta publikojë vendimin e Komisionit për ankesa.

Me respekt,
Këshilli për etikë në mediat e Maqedonisë

Kryetar i Komisionit për ankesa
Mirçe Adamçevski

